

## **SYLLABUSI I TRAJNIMIT ME TEMË “SIGURIA E ENERGJISË NË RAJONIN E BALLKANIT PERËNDIMOR”**

*PËRGATITUR NGA QENDRA E TRAJNIMEVE DHE EDUKIMIT PRANË ACERC*

Për sa i përket sigurisë së furnizimit me energji, nuk ka dyshim që detyra për sigurimin e saj në përputhje me *acquis*-in e Komunitetit të Energjisë i përket autoriteteve kombëtare të secilit vend. Në të njëjtën kohë do të përbente një “mendjelehtësi” të besuarit se origjina dhe efektet e sigurisë së krizave të furnizimit apo edhe efektet e ndërprerjeve ndalen në kufijtë kombëtare të shtetit direkt të prekur. Pra krizat, parandalim dhe reagim janë për nga natyra çështje që thellësisht nuk njohin dhe nuk ndalen përpara kufijve ndërshtetërore.

Si shprehje e rëndësisë së saj Traktati i Komuniteti të Energjisë bën disa referenca për sigurinë e furnizimit me energji. Në këtë qëllim, tre masa të dallueshme janë dizajnuara për të rritur sigurinë e furnizimit në rajonin e Komunitetit të Energjisë.

- Skicimi i kornizës së sigurisë së furnizimit,
- Masat mbrojtëse për sigurinë,
- Ndihma e ndërsjellë.

Koncepti i sigurisë së furnizimit përfshin reduktimin e varësisë së jashtme, nëpërmjet implementimit të infrastrukturës gjeneruese dhe të transportit (pra për diversifikimin e furnizimit me energji) dhe objekteve të magazinimit si në rastin e gazit natyror. Për me shumë struktura të larmishme të furnizimit bene që secili vend që e aplikon atë të zëre një pozitë më të mirë për t’iu kundërvënë “kërcënimeve” të çrregullimit të papritur të energjisë. Në këtë kuadër është thelbësore që këto përpjekje të mos të dëmtojnë por të plotësojnë liberalizimin gjithëpërfshirës të tregjeve kombëtare të energjisë.

Përmbajtja më sipër përcakton dhe instrumentet hulumtuese për të ndërtuar një prezantim mbi sigurinë e furnizimit dhe detyrimeve që duhen përmbushur. Këto përbejnë të detyrueshme ndër të tjera rekomandimet dhe rezultatet e dala nga “Testet e Stresit në rrafshet evropiane”, Korniza e Sigurisë së Furnizimit, dhe puna e Grupit Koordinues për sigurinë e furnizimit, duke përfshirë pjesëmarrjen në Grupin Koordinues të Gazit të BE-së. Gjithashtu

Trajnimi do të përqendrohet në zbatimin e Rregullores 994/2010/BE dhe mbi te disatat mësimet tashme lidhur me sigurinë e furnizimit që kanë shoqëruar ngjarjet e viteve të fundit.

## **Temat e referencës**

Trajnimi, do të mbështetet në seksionet e nënrenditura këtu ne vijim:

### **I. Sektori Energjetik në Rajonin e Ballkanit Perëndimor**

#### **Pasqyrë e sektorit energjetik në rajonin e Ballkanit Perëndimor**

Kuadër i përgjithshëm i burimeve kryesore të energjisë dhe strukturës së vendeve të Ballkanit Perëndimor, përveç rastit të Shqipërisë, që do të analizohet në mënyrë të veçantë.

- Bosnja dhe Hercegovina
- Kroacia
- Kosova
- Maqedonia
- Mali i Zi
- Serbia

#### **2. Komuniteti i Energjisë**

Vendet e rajonit të Ballkanit (jo-anëtare të BE-së), janë anëtare të Komunitetit Energjetik, i cili ka si objektiv implementimin e 'Aquis' mbi energjinë. Një përshkrim i shkurtër i karakteristikave dhe detyrimeve që ka ky Komunitet, si dhe detyrimet që kanë anëtarët e saj, do të shpjegohen në paragrafin e mëposhtëm.

#### **3. Aktorët e tretë në rajonin e Ballkanit Perëndimor**

- Shoqëritë e huaja kryesore që operojnë në sektorin energjetik;
- Ndërlidhjet strategjike dhe marrëdhëniet dypalëshe.

### **II. Sektori Energjetik në Shqipëri**

Përmbledhje e sektorit energjetik në Shqipëri.

#### **1. Burimet energjetike kryesore**

- Nafta dhe Gazi;
- Hidroenergja;
- Energjitë ripërtëritëse;
- Të tjera.

#### **2. Tregu Energjetik**

- Rrjeti elektrik;
- Rrjeti i gazit;
- Energjitë ripërtëritëse;
- Nevojat energjetike të mbuluara nga burimet e veta dhe nga importi.

### 3. Projekti i TAP-it

- Përshkrim i shkurtër i projektit dhe situatës aktuale;
- Rëndësia strategjike e projektit;
- Rëndësia strategjike e Shqipërisë në tregun energjetik në rajonin e Ballkanit.

### III. Mbyllja e Projektit South Stream dhe Pasojat për Evropën Lindore

1. Vështrim i Projektit South Stream: Situata aktuale e Projektit;
2. Rëndësia strategjike e Projektit South Stream;
3. Pasojat e mbylljes së Projektit për Evropën Lindore.

### IV. Çështjet mbi Sigurinë Energjetike

- Çështjet aktuale të Sigurisë Energjetike;
- Gjetjet e Komisionit Evropian nga Raportimi i Testit të Stresit

### V. Konkluzione dhe Sugjerime

Për me shume mbetemi ne gatishmëri për vijimin me çdo informacione shtese qe do te kërkohet.

Drejtor i Projektit

Dr. Lorenc Gordani